

VENDIM
Nr.568, datë 12.8.2005

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.114, DATË 27.2.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË THIRRJES DHE
PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHTETASIT QË DO TË KRYEJNË SHËRBIMIN E
DETYRUESHËM USHTARAK, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.65, DATË
2.2.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR THIRRJEN E SHTETASVE PËR
SHËRBIMIN USHTARAK AKTIV OSE NË REZERVË, KOMPLETIMIN E REPARTEVE
USHTARAKE ME REZERVISTË, AUTOMJETE E TEKNIKË TJETËR, KAFSHË PUNE, SI
DHE ORGANIZIMIN E SISTEMIT TË LAJMËRIMIT””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 5 të vendimit nr.114, datë 27.2.2004 të Këshillit të Ministrave, të shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1. Kryerja e pagesave të korrierëve për thirrjen e shtetasve për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, për vitin 2005, do të bëhet nga qendrat e rekrutim-mobilizimit, pranë çdo njësie të qeverisjes vendore, në bazë të dokumentacionit të përgatitur për këtë qëllim nga kjo njësi vendore.

Dokumentet e nevojshme për kryerjen e pagesave të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Mbrojtjes dhe të Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano